



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Tetor 2022

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Tetor 2022

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në këtë edicion të këtij buletini pasqyrohen
aktivitetet për muajin tetor të vitit 2022)**

Finalizohet drafti i Rregullore për Administratën e KPK-së

Komisioni për Çështje Normative i KPK-së mbajti takimin e radhës, me ç'rast bëri shqyrtimin përfundimtar të Draftrregullore për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës në KPK, pas harmonizimit të disa dispozitave të plotësuara nga administrata e Sekretariatit të KPK-së.



Anëtarët e Komisionit për Çështje Normative vendosën që drafti i finalizuar i kësaj rregulloreje të dërgohet për miratim në njërin nga takimet e radhës së Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Përfaqësues të sistemit prokurorial vizitojnë Gjykatën e Qarkut në Oslo

Një delegacion i sistemit prokurorial ka zhvilluar një vizitë në Gjykatën e Qarkut në Oslo të Norvegjisë.



Në kuadër të kësaj vizite u zhvilluan diskutime me qëllim të përfitimit nga shkëmbimi i përvojave dhe i

praktikave të mira, sidomos nga ato që ndërlidhen me menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë informative në fushën e drejtësisë, përfshirë edhe statistikat, analizat dhe përdorimin e informacionit, i cili ndikon në fuqizimin dhe avancimin e SMIL-it, përshkrimin e modeleve të operimit, mirëmbajtjen dhe modelet konkrete të financimit të tij, të cilat nevojiten për të mbajtur të përditësuar infrastrukturën thelbësore.

Aprovohet drafti i Rregulloreve për praktikantë në sistemin prokurorial

Komisioni për Çështje Normative mbajti takimin e tij të radhës, me ç'rast është shqyrtuar draftin e Rregulloreve për praktikantë në sistemin prokurorial.



Anëtarët e këtij Komisioni potencuan se përmes kësaj rregulloreje do të bëhet i mundshëm angazhimi i kuadrove të reja për t'u aftësuar dhe për t'u përgatitur për punë.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Komisioni për Administrimin e Prokurorive mbajti takimin e radhës, ku në fokus kishte shqyrtimin e analizës për numrin e nevojshëm të prokurorëve në Prokurorinë e Apelit, me ç'rast u theksua se nga ky vlerësim do të nxjerrën rekomandimet që do të dërgohen në Këshill për t'u miratuar në njërin nga takimet e ardhshme të tij.



Pjesë e diskutimit ishte edhe drafti i agjendës së punëtorisë që planifikohet të mbahet për administratorë, që ndërlidhet kryesisht me prezantimin e raporteve të monitorimit të zbatimit të SMIL-it në sistemin prokurorial.

Monitorohet zbatimi i akteve nënligjore në Prokurorinë Themelore të Pejës dhe atë të Gjakovës

Në vazhden e monitorimit të zbatimit të akteve nënligjore dhe me qëllim të përbushjes së detyrave të punës, anëtarët e Komisionit për Çështje Normative vizituan prokuroritë themelore të Pejës dhe Gjakovës, ku janë pritur nga kryeprokurorët përkatës të këtyre prokurorive.



Në takimet e zhvilluara në dy prokuroritë përkatëse anëtarët e Komisionit për Çështje Normative u njoftuan për zbatimin e akteve nënligjore në fuqi dhe akteve që janë në proces të hartimit, diskutimit dhe miratimit në KPK, lehtësimin e qasjes në to, sfidat dhe vështirësitë në zbatimin e tyre dhe propozimet eventuale për plotësimin dhe ndryshimin e akteve normative në përgjithësi.



Themelohet komisioni për zgjedhjen e anëtarit të KPK-së nga radha e Prokurorisë së Apelit

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka mbajtur takimin e 220-të me radhë, me ç'rast janë prezantuar raportet për periudhën janar-qershor 2022 të Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional për veprat penale karakteristike dhe Komisionit mbikëqyrës për monitorimin e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike që rrjedhin nga Plani Strategjik i Sistemit Prokurorial 2022-2024. Po ashtu, për gjashhtëmuorin e parë të vitit 2022 kanë raportuar edhe kryetarët e komisioneve të përhershme të KPK-së, raporte të cilat janë miratuar me disa rekomandime.



Në vazhdim, anëtarët kanë miratuar Udhëzimin për përdorimin e simboleve dhe vulave në sistemin prokurorial, si dhe kanë avancuar, sipas rekomandimit të Komisionit për transferimin dhe avancimin e prokurorëve, prokurorin Sadri Alija nga Departamenti i Përgjithshëm në atë për të Mitur të Prokurorisë Themelore të Gjakovës. Ndërsa, për Prokurorinë e Apelit është marrë vendim për shpalljen e brendshme për avancimin e 3 prokurorëve në këtë prokurori.

Gjatë këtij takimi janë miratuar Dokumenti i politikave të trajnimit për prokurorët dhe stafin administrativ të sistemit prokurorial si dhe Plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve dhe stafit administrativ, të cilat do të dërgohen në Akademinë e Drejtësisë për hartimin e programit trajnues për vitin 2023.

Takimi ka vazhduar me themelimin e Komisionit për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit.

Po në këtë takim, Këshilli ka marrë vendim për shpalljen e konkursit për Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Drejtorin e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë si dhe ka themeluar Komisionin rekrutues për këto 2 pozita.

Në fund të takimit u miratua raporti për vlerësimin e performancës së 11 prokurorëve me mandat të përhershëm.

Reduktohen esencialisht aktivitetet e punës në Prokurorinë e Apelit dhe atë Themelore të Prishtinës

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka marrë vendim për reduktimin esencial të aktiviteteve të punës në Objektivin C të Pallatit të Drejtësisë, aty ku janë të vendosura Prokuroria e Apelit dhe Prokuroria Themelore e Prishtinës. Ky reduktim në këto dy prokurori vjen si rezultat i gjendjes së rënduar në këtë objekt, si pasojë e mungesës së theksuar të oksigjenit dhe problemeve shëndetësore të shfaqura në baza ditore tek prokurorët dhe stafi mbështetës i këtyre dy prokurorive.



Me qëllim të realizimit të punëve emergjente, këto dy prokurori do të caktojnë prokurorë dhe staf administrativë për të kujdestaruar dhe realizuar vetëm veprimtaritë e natyrës urgjente dhe veprimet e caktuara sipas afateve ligjore.

Situata e krijuar në këtë objekt me pasoja shëndetësore nuk i takon përgjegjësisë së Këshillit Prokurorial të Kosovës, duke qenë se i njëjti ka ndërmarrë veprime të njëpasnjëshme brenda kompetencave të veta për gjetjen e një zgjidhjeje të këtij problemi madhor. Ky objekt është nën menaxhimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila është kompetente dhe përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të mëtutjeshme.

Të gjendur para kësaj suate, i bëjmë thirrje Ministrisë së Punëve të Brendshme që të implementojnë sa më shpejtë kontratën për hapjen e dritareve në këtë objekt. Deri në realizimin e këtij projekti, prokuroritë e lartcekura do të punojnë sipas planit emergjent.

Këshilli Prokurorial i Kosovës nuk do të mbajë përgjegjësi për kallëzimet penale dhe paditë civile eventuale që mund të paraqiten lidhur me pasojat

shëndetësore të shkaktuara nga qëndrimi në këtë objekt.

Kryesuesi i KPK-së priti në takim një delegacion të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë nga Republika e Shqipërisë

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës së bashku me Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale kanë pritur në takim Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD) së Republikës së Shqipërisë me bashkëpunëtorë.



Me këtë rast u diskutuan për identifikimin e mënyrave të bashkëpunimi dhe shkëmbimit të përvojave, si dhe intensifikimin e bashkëpunimit përmes krijimit të grupeve të përbashkëta, me qëllim të arritjes së objektivave në fushat përkatëse të punës.

Sistemi prokurorial vazhdon dhurimin vullnetar të gjakut

Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe institucioni i Prokurorit të Shtetit në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzion të Gjakut në kuadër të dhurimit të rregullt vullnetar të gjakut organizuan një aksion, me ç'rast ftesës për dhurim iu përgjigjën një numër i konsiderueshëm i zyrtarëve të sistemit prokurorial.



Një bashkëpunim i tillë në mes të sistemit prokurorial dhe Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut vazhdon për vite të tëra, duke organizuar dhe

realizuar akte të tilla humane, që shpëtojnë jetë njerëzish.

Fjalimi i Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Jetish Maloku, me rastin e shënimit të Javës për të Drejtat e Viktimave të Krimit

I nderuar U.D. Kryeprokuror i Shtetit, z. Besim Kelmendi,

Shkëlqesia Juaj, znj. Vjosa Osmani, Presidente e Republikës së Kosovës,

E nderuara Kryetare e Gjykatës Kushtetuese, znj. Gresa Caka -Nimani,

I nderuar Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z. Jeffrey Hovenier,

E nderuara Ministre e Drejtësisë, znj. Albulena Haxhiu,

I nderuari Kryetar i Gjykatës Supreme, z. Enver Peci,

I nderuari Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Albert Zogaj,

Të nderuar drejtues të institucioneve vendore dhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare,

Të nderuar kryeprokurorë të prokurorive, prokurorë, kryetarë të gjykatave, gjyqtarë, policë dhe ju mbrojtës të viktimave të krimit,



Jam i nderuar të jem pjesë e kësaj konference dhe në emër të Këshillit Prokurorial të Kosovës të prezantoj angazhimin e vazhdueshëm të këtij institucioni në mbrojtje të viktimave të krimit.

Bazuar në kompetencat tona, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka përkrahur institucionin e Prokurorisë së Shtetit për ndërtimin e një zyre të qëndrueshme të mbrojtjes së viktimave, duke i ofruar asaj profesionistë dhe infrastrukturë të nevojshme ligjore dhe teknike, në

mënyrë që viktimat e krimit të mos harrohen gjatë administrimit të drejtësisë, por të ndihen të sigurt dhe të mbrojtur në aspektin fizik dhe psikologjik.

Në këtë drejtim, vlerësojmë lart angazhimin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë për Viktimat dhe, në veçanti, angazhimin e institucionit të Prokurorit të Shtetit.

Të nderuar prokurorë të Shtetit,

- Detyra dhe roli juaj të mos shihet vetëm si angazhim simbolik, por mbi të gjitha të jetë angazhim aktiv dhe i fuqishëm në përfaqësimin e interesave të viktimave të krimit;

- Keni obligim të jeni në krah të viktimave, në mënyrë që të mos ndjehen të vetmuara dhe pa përkrahje të institucioneve relevante;

- Keni detyrim që procedurat penale të mos shtojnë vuajtjet e viktimave të krimit, përkundrazi, të ndërtojnë besim dhe siguri në institucionet relevante.

Askush nuk kërkon privilegje të veçanta për viktimat e krimit dhe as mohim të të drejtave të akuzuarit, por vetëm barazi në trajtim, e cila mungon në shumë raste.

Prandaj, prokurorë të nderuar, kthejeni besimin, jo vetëm të dëshmitarëve, por edhe të viktimave të krimit, ndryshe sistemi ligjor dhe sundimi i ligjit në vendin tonë do të mbetet i dobët dhe kriminelët do të shëtisin të lirë, pa frikë nga ndëshkimi (dënimi).

Përkundër ndryshimeve të mëdha dhe avancimit të procedurave në Kosovë, institucionet tona kanë ende shumë për të bërë në këtë fushë dhe për këtë nuk mjafton vetëm vullneti i individëve apo i grupeve të individëve, por do të duhej avancim i tërë shoqëror për ngritjen e vetëdijes në mbrojtjen e viktimave të krimit nga ana e institucioneve, por edhe nga shoqëria.

Andaj, kërkojmë nga institucionet kompetente që të na përkrahin sipas kompetencave të tyre me mjetet buxhetore, me qëllim të kompletimit të infrastrukturës ligjore dhe teknike, siç e kërkon ligji.

Në këtë drejtim, përkrahje të madhe në këtë fushë kemi pasur në vazhdimësi nga miqtë tanë ndërkombëtarë, ndaj të cilëve jemi shumë mirënjohës. Në veçanti, vlerësoj lart ndihmën e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila në mënyra dhe forma të ndryshme ka kontribuar në avancimin e të drejtave të viktimave të krimit.

Gjithashtu, besojmë shumë se kompensimi i tyre ka rëndësi të madhe si formë e ndihmës dhe përkrahjes materiale, shëndetësore dhe psikologjike, deri në rehabilitim dhe integrim të plotë të tyre.

Krejt në fund, prokurorë të nderuar, besojmë se duke mbrojtur viktimat e krimit ndërtojmë një ambiente të qetë, të sigurt dhe të shëndoshë për tërë shoqërinë tonë.

Ju falënderoj për vëmendjen tuaj dhe kontributin e të gjitha institucioneve të pranishme këtu dhe atyre që angazhohen në këtë drejtim.

Kërkohej përkushtim i vazhdueshëm në trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike

Komisioni Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike ka vizituar Prokurorinë Themelore të Ferizajt, me ç'rast janë pritur nga Kryeprokurori i kësaj prokurorie.



Gjatë këtij takimi është diskutuar lidhur me lëndët e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, trajtimin e tyre dhe sfidat e ndryshme, që dalin në rrugën që ka përpara kjo prokurori.

Në këtë takim, anëtarët e Komisionit, përkundër rezultateve të arritura në trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike në këtë prokurori, kërkuan një përkushtim të vazhdueshëm në trajtimin e këtyre lëndëve.

Në fund të takimit anëtarët e Komisionit thanë se luftimi i korrupsionit duhet të jetë prioritet sepse është në interes nacional të vendit.

Mbahet takimi i parë i përbashkët ndër-institucional

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në bashkërendim me Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë, Gjykatën Supreme të Kosovës dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, kanë mbajtur sot takimin e parë të përbashkët ndër-institucional. Ky takim, ishte një platformë pikënisëse për të diskutuar dhe shqyrtuar mundësitë e një qasje të përqendruar dhe dakorduar

ndër-institucionale për të vënë në lëvizje një nismë të përbashkët ligjore dhe rregullative.



Kjo nismë mëton t'i adresojë çështjet që kanë dalë nga Raporti për vendin i Komisionit të Bashkimit Evropian, Strategjia për Sundimit e Ligjit si dhe rekomandimet e Opinionit të Komisionit të Venecias.

Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

Sekretariati i KPK-së, gjatë muajit tetor, ka përgatitur Marrëveshjen e Bashkëpunimit në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe të Doganës për shkëmbimin elektronik të të dhënave dhe ka mbajtur takim me përfaqësues të IRZ-së lidhur me projektet e realizuara dhe ato që do të realizohen në vitin 2023 nga kjo organizatë.

Nga ana tjetër, ka filluar procesi i regjistrimit të lëndëve reale në ZKPSH dhe ka mbajtur një takim me ekspertët e Projektit EUKOJUST për arkivimin e lëndëve në SMIL, si dhe me përfaqësuesit e Akademisë së Drejtësisë ku është diskutuar përgatitja e modulit për mbajtjen e trajnimit për përdorimin e SMIL-it nga prokurorët.

Ndërkohë është mbajtur edhe një takim i rëndësishëm me KGJK-në, ku është diskutuar shkëmbimi i të dhënave për instancën e dytë (Gjykata e Apelit – Prokuroria e Apelit), si dhe është përgatitur Udhëzuesi për ngritjen e nivelit të njohurive për parandalimin e krimeve kibernetike.

Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

NJSHPP-ja, gjatë muajit tetor 2022, kanë qenë e përqendruar në hartimin e raportit analitik për numrin e nevojshëm të prokurorëve në Prokurorinë e Apelit konform ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, hartimin e raportit nëntëmujor të punës së Prokurorit të Shtetit, mbështetjen e procesit të rekrutimit të prokurorëve, mbështetja e zbatimit dhe administrimit të

testit me shkrim për kandidatët për prokurorë, komentet për avancimin e mëtejshëm të raporteve të SMIL, pjesëmarrje në takimin e Komisionit për Administrimin e Prokurorive dhe prezantim i raportit sipas agjendës, hartimin e raportit infografik për veprat penale karakteristike, që publikohen në web portal, pjesëmarrje në takimin me ekspertët e CEPEJ të projektit KOSEJ në kuadër të Këshillit të Evropës ku është diskutuar për format e raportimit përmes SMIL, përgatitja e planit individual të trajnimit për zyrtarët e ZMAVP-së dhe hartimi i raporteve të rregullta.